



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 183, Datë 10.11.2017**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SH.A. PËR NJË NDRYSHIM NË  
“KONTRATËN E SHIT-BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET  
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË  
CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA  
SHTETI/KESH SH.A. DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT  
UNIVERSAL/OSHEE SH.A., PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË  
PËR PERIUDHËN 01.01.2017-31.12.2017”, MIRATUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË ERE NR. 62, DATË 11.05.2017**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike; si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike mbi kërkesën e OSHEE sh.a për ndryshimin e pikës 1 të nenit 9 të “Kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike, ndërmjet KESH dhe OSHEE, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017-31.12.2017”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 62, datë 11.05.2017,

**Konstatoi se:**

Në mbështetje të VKM-së 244/2016, me vendimin nr. 62, datë 11.05.2017, ERE ka miratuar “Kontratën e shit-blerjes së energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017-31.12.2017”.

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 21380, datë 20.09.2017, ka përcjellë në ERE kërkesën për ndryshimin e pikës 1 të nenit 9 të “Kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE

sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017-31.12.2017”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 62, datë 11.05.2017.

- MIE me shkresën nr. 5643/9 prot., datë 28.09.2017, shprehet se kërkesa e OSHEE sh.a. për ndryshimin e kontratës aktuale ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a. nuk gjen mbështetje në parashikimet e VKM-së nr 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.
- KESH sh.a. me shkresën nr. 4858/1 prot., datë 27.09.2017, shprehet se propozimi i OSHEE sh.a. është i papabuar dhe në kundërshtim me VKM datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, por edhe nuk përputhet me detyrimet që burojnë nga licenca e KESH dhe ajo e OSHEE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. mbi ndryshimin e pikës 1, neni 9 të Kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike, nga shoqëria e prodhimit aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 62, datë 11.05.2017”.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**